

**AKTI I THEMELIMIT DHE STATUTI I
SHOQËRISË ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR
“SAPA CONSULTING” SHPK**

**KAPITULLI I
EMËRTIMI, FORMA, SELIA, OBJEKTI DHE KOHËZGJATJA**

Neni 1 –Themeluesi, Emërtimi dhe Forma e Shoqërisë

- 1.1 Shoqëria emërtohet si “**SAPA CONSULTING**” SHPK (në vijim “**Shoqëria**”).
- 1.2 Shoqëria themelohet në përputhje me legjislacionin shqiptar në formën e shoqërisë me përgjegjësi të kufizuar dhe rregullohet prej këtij Statuti dhe legjislacionit shqiptar në fuqi.
- 1.3 Shoqeria do te kryej aktivitetin e saj ekonomik brenda territorit te Republikes se Shqiperise dhe jashte saj duke permbushur te gjithe kriteret e kerkuar nga ligji vendit ku do te ushtrohet aktiviteti ekonomik.
- 1.4 Shoqëria ka vulën dhe logon e saj zyrtare.
- 1.5 Themeluesi i shoqerise/ortak i vetem eshte: **Z. LEK TUSHAJ**, i datelindjes 21.08.1970, lindur ne Shkoder dhe banues ne Tirane, madhor, me zotesi te plete juridike dhe per te vepruar, i identifikuar nga karta e identitetit me NID **H00821071F**.

Neni 2 – Selia

- 2.1 Selia e Shoqërisë është në adresën: Tirane, Njesia Bashkiake Nr. 9, Rruga “Asim Vokshi”, pallati Nr.14, shk. 2, k. 9, Ap. 46.
- 2.2 Shoqëria mund të ketë adresa sekondare, zyra, degë, zyra përfaqësimi dhe agjenci në adresë të tjera qe Asambleja e Përgjithshme mund të çelë, transferojë dhe/apo mbyllë, si në Shqipëri ashtu edhe jashtë saj, degë dhe/ose zyra përfaqësimi dhe njësi vendore të çdo lloji.
- 2.3 Cdo adrese sekondare e shoqerise duhet te deklarohet/registrohet ne QKB.

Neni 3 – Objekti i veprimtarise

- 3.1 Shoqeria kryen aktivitetin e saj ekonomik ne fushen e konsulences, projektimit, mbikqyrjes dhe/ose kolaudimit per punimet e per gjithshme te ndertimit ne zbatim, pavaresisht nese keto realizohen me fonde publike, fonde private apo sponsorizime, duke perfshire, por pa u kufizuar ne to, konsulencen, mbikqyrjen dhe/ose kolaudimin e punimeve te ndertimit ne zbatim te kategorive si vijojne:

- Punime gërmimi në tokë,
- Ndërtimë civile dhe industriale,
- Rikonstruksion dhe mirëmbajtje godinash civile e industriale, veshje fasada,
- Rrugë autostrada, ura, mbikalime, hekurudha, linja tramvaji, metro, hekurudhë me kavo
- dhe pista aeroportuale,
- Punime nëntokësore, ura e vepra arti;
- Diga dhe tunele hidroteknike;
- Ujësjellës, gazsjellës, vajsjellës, vepra kullimi e vaditje;
- Ndërtimë detare dhe punime thellimi në ujë;
- Punime dhe mbrojtje lumore sistemime hidraulike dhe bonifikime;
- Ndertimin e impjanteve per prodhimin e energjise;
- Ndërtimë për N/stacionet, kabinat e transformatorëve linja e TN e të mesëm dhe shpërndarjen e energjisë;
- Punime të inxhinierisë së mjedisit;

3.2 Gjithashtu shoqeria kryen aktivitetin e saj ekonomik ne fushen e konsulences, projektimit, mbikqyrjes dhe/ose kolaudimit per punime speciale ndertimi ne zbatim, pavaresisht nese keto realizohen me fonde publike, fonde private apo sponsorizime, duke perfshire, por pa u kufizuar ne to, konsulencen, mbikqyrjen dhe/ose kolaudimin e punimeve te ndertimit ne zbatim te kategorieve si vijojne:

- Punime për prishjen e ndërtimeve;
- Impante hidro-sanitare, kuzhina, lavanderi, mirëmbajtja e tyre;
- Impjante hidro-termosanitare dhe mirembajtja e tyre;
- Impjante ngritese dhe transportuese (ashensore, shkalle levizese, transportues);
- Punime rifiniture të muraturës dhe të lidhura me to, rifiniturë me materiale druri, plastik, metalik dhe xhami dhe rifiniturë të natyrës teknike ndërtuese;
- Impjante të sinjalistikës ndriçuese të trafikut;
- Sinjalistika rrugore jondriçuese;
- Bariera dhe mbrojtje rrugore;
- Ndërtime parafabrikat beton arme, struktura metalike dhe druri;
- Punime strukturore speciale;
- Punime mbi shina dhe traversa;
- Impjante teknologjik, termike dhe të kondicionimit;
- Impjante dhe linja telefonie dhe telekomunikacionit;
- Impjante të brendshme, elektrike, telefoni, radiotelefoni TV etj.
- Pastrimi i ujërave detarë, lijenor dhe lumor;
- Ndërtimi i impianteve të ujit të pijshëm dhe pastrimit të tij;
- Ndërtimi i impianteve të grumbullimit dhe trajtimit të mbetjeve urbane;
- Punime topogjeodezike;
- Sistemet kundra zhurmës për infrastrukturë.
- Shpime gjeologo-inxhinierike, puse e shpime për ujë.

3.3 Ne funksion te realizimit te objektit sa me siper, shoqeria kryen gjithashtu cdo veprimitari tjeter ndihmese/aksesore/qe lidhet me te dhe qe i sherben perfundimit me sukses te veprimtarise sa siper.

3.4 Shoqeria mund te realizoj gjithashtu cdo veprimitari ekonomike tjeter qe eshte e lejueshme nga legjislacioni shqiptar.

3.5 Gjithashtu, Shoqëria mund të kryejë cdo lloj veprimtarie apo transaksion tjetër që lidhet me pasuri të luajtshme e të paluajtshme, me kryerjen e veprimeve tregtare, industriale, bankare dhe/ose financiare të cfarëdo lloji dhe natyre, të nevojshme ose të dobishme për arritjen dhe ose plotësimin e objektivit të Shoqërisë, që ndihmojne aktivitetin parësor të Shoqërisë dhe nuk bie në kundërshtim me legjislacionin shqiptar në fuqi.

Neni 4 – Kohëzgjatja

4.1 Shoqëria do të ketë një kohëzgjatje të pakufizuar.

4.2 Shoqëria mund të prishet, ndahet, bashkohet me një shoqeri tjeter në çdo moment me vendim të Asamblesë së Përgjithshme te artakeve dhe duke respektuar te gjitha procedurat ligjore.

KAPITULLI II KAPITALI, KONTRIBUTET, NDARJA DHE TRANSFERIMI I KUOTAVE TË SHOQËRISË

Neni 5 – Kapitali i Shoqërisë, kontributet dhe kuotat

5.1. Kapitali i ortakut te shoqerise eshte i shprehur ne monedhen Lek. Ortaku i vetem i shoqerise ka vendosur qe kapitali i nenshkruar te jete **100'000 ALL (njeqind mijë Lek) ose, i ndare ne 1 (nje) kuote te vetme me vleren **100'000 ALL (njeqind mijë lek)**. Kjo**



vlere do te derdhet ne llogarine bankare te hapur ne emrin e shoqerise brenda 30 diteve nga krijimi i saj.

- 5.2 Pjesemarrja e ortakut themelues ne kapitalin e shoqerise eshte si me poshte:
Ortaku themelues z. LEK TUSHAJ eshte kontribues i 100% te kapitalit te shoqerise dhe si rrjedhim zoterues i 1 kuote.

Neni 6 – Zmadhimi dhe Zvogëlimi i kapitalit të Shoqërisë

- 6.1 Rritja e kapitalit mund të kryhet me vendim të Asamblesë, kurdo dhe për më shumë se një herë, përmes kontributit në para apo në natyrë, në zbatim të dispozitave ligjore.
- 6.2 Zvogëlimi i kapitalit të Shoqërisë mund të kryhet me vendim të Asamblesë, në përputhje me dispozitat ligjore në fuqi. Në çdo rast kapitali i Shoqërisë nuk mund të zvogëlohet nën minimumin e parashikuar me ligj.

Neni 7 – Transferimi i Kuotes

- 7.1 E drejta e pronësisë mbi kuoten është lirisht e transferueshme tek të tretët në përputhje me dispozitat e Ligjit nr.9901, datë 14 mars 2008 “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”, i ndryshuar.
- 7.2 Ndalohet krijimi i të drejtave reale mbi kuotat e Shoqërisë me qëllim garantimin e detyrimeve të një palë të tretë, me ose pa pagesë, përveçse kur me vendim të Asamblesë së Përgjithshme parashikohet ndryshe.

KAPITULLI III

ASAMBLEJA E ORTAKËVE, ADMINISTRATORËT DHE EKSPERTI KONTABËL I AUTORIZUAR

Neni 8 – Asambleja e Përgjithshme, të drejtat e pjesëmarrjes dhe votës, thirrja

- 8.1 Organi vendimmarrës i Shoqërisë është Asambleja e Përgjithshme, në të cilën marrin pjesë të gjithë ortakët e Shoqërisë/ortaku i vetem i
- 8.2 Secili ortak ka të drejtën të marrë pjesë në Asamblenë e Përgjithshme, të shpreh mendimin e tij dhe të japë votën, për aq sa ç’është përqindja e zotëruar prej tij në kapitalin e Shoqërisë.
- 8.3 Secili ortak ka të drejtën të përfaqësohet nga një person tjetër, edhe jo ortak, i pajisur me një prokurë, përmes së cilës do të mund të shprehë votën e vet. Në çdo rast, prokura do të mund të lëshohet vetëm për një Asamble ortakësh, dhe është e vlefshme për thirrjen e parë dhe të dytë.
- 8.4 Ortaku nuk mund të japë prokurë vote për një pjesë të kuotës së zotëruar prej tij, nëse voton personalisht për një pjesë të tyre.
- 8.5 Asambleja e Përgjithshme mund të thirret edhe jashtë selisë së Shoqërisë në Shqipëri apo jashtë saj. Pranohet mundësia që Asambleja e Përgjithshme të zhvillohet me video/telekonferencë, me kusht që të gjithë pjesëmarrësit të mund të identifikohen, t'u mundësohet të ndjekin bisedën, të ndërhyjnë e japin mendimet e tyre në kohë reale lidhur me trajtimin e argumenteve dhe të votojnë në të njëjtën kohë mbi pikat e rendit të ditës. Pas verifikimit të elementeve të mësipërme, të cilat duhet të pasqyrohen në



procesverbalin e mbledhjes, mbledhja do të prezumohet e zhvilluar në vendin ku Kryetari i mbledhjes dhe Sekretari, njëkohësisht kanë qenë të pranishëm.

- 8.6 Në çdo rast, Asambleja e Përgjithshme duhet të mblidhet të paktën një herë në vit brenda muajit të gjashtë të vitit finanziar, me qëllim që të diskutojë, analizojë dhe miratojë bilancin vjetor, raportin e administratorit dhe të eksperit kontabël të autorizuar (nëse është emëruar).
- 8.7 Asambleja e Përgjithshme duhet të thirret përmes një letre rekomande me kthim përgjigje apo me postë elektronike dërguar në adresën e tyre të banimit apo në adresën e tyre elektronike, të paktën 7 (shtatë) ditë përpëra ditës së përcaktuar për zhvillimin e Asamblesë.
- 8.8 Njoftimi duhet të përbajë rendin e ditës dhe të tregojë datën, vendin dhe orën ku do të zhvillohet mbledhja e Asamblesë dhe eventualisht edhe datën, vendin dhe orën e mbledhjes së dytë, nëse e para nuk arrin të mblidhet.
- 8.9 Asambleja e Përgjithshme konsiderohet si e thirrur në mënyrë të vlefshme dhe e mbledhur edhe nëse të gjitha formalitetet që kanë të bëjnë me thirrjen e saj nuk janë respektuar, me kusht që i gjithë kapitali i Shoqërisë të jetë i pranishëm apo i përfaqësuar me prokurë dhe që të gjithë ortakët të pranojnë të marrin vendim pavarësisht parregullsisë së thirrjes.
- 8.10 Nëse përbushen këto kushte, Asambleja e Përgjithshme konsiderohet si e zhvilluar në vendin ku ndodhet Kryetari i mbledhjes dhe ku gjithashtu duhet të ndodhet edhe Sekretari, në mënyrë që të aprovojnë hedhjen dhe nënshkrimin e procesverbalit mbi librin përkatës.
- 8.11 Në thirrjen e mbledhjes së Asamblesë e Përgjithshme duhet të jenë të përcaktuar vendet, edhe jashtë selisë së Shoqërisë, të lidhur me video/telekonferencë nën kujdesin e Shoqërisë, ku ortakët do të mund të mblidhen.
- 8.12 Kryetari i Asamblesë së Përgjithshme ka të drejtë të plotë të verifikojë prokurat dhe vlefshmërinë e tyre, të drejtën e Përgjithshme dhe përfaqësuesve të tyre për të marrë pjesë në Asamble dhe të vendosë nëse kjo e fundit është mbledhur në mënyrë të rregullt dhe nëse kuorumi i nevojshëm për të marrë vendime është arritur vlefshmërisht.
- 8.13 Kryetari ka edhe të drejtën të kryesojë bisedimet dhe të marrë vendime mbi rregullat dhe procedurat lidhur me votën.
- 8.14 Vendimet, procesverbalet dhe lista e pjesëmarrësve të Asamblesë duhet të përgatiten menjëherë pas Asamblesë dhe duhet të nënshkruhen prej Kryetarit dhe Sekretarit të Asamblesë, sikurse edhe prej noterit, kur kjo kërkohet nga kuadri ligjor në fuqi. Lista e pjesëmarrësve i bashkëlidhet procesverbalit të mbledhjes si dhe cdo dokumentacion tjetër në lidhje me vendimmarrjen e Asamblesë së Përgjithshme. Administratori/ët, është/janë përgjegjës për mbajtjen e kopjes së dokumentacionit të sipërcituar.

Neni 9 –Kompetencat e Asamblesë dhe Kuorumi

- 9.1 Asambleja e Përgjithshme vundos mbi çështjet e mëposhtme:
 - a. zmadhimin ose zvogëlimin e kapitalit themeltar;
 - b. ndryshimi i statutit të Shoqërisë;



- c. transformimin, ndarjen, bashkimin, likuidimin ose prishjen e Shoqërisë, si dhe riorganizimin e saj në çdo formë tjetër;
- d. pjestimin e kuotes së Shoqërisë dhe anullimin e tyre;
- e. përcaktimin e politikave tregtare të Shoqërisë dhe planin strategjik të zhvillimit dhe mbikëqyr zbatimin e tyre nga Administratori, përfshirë raportimet financiare;
- f. miratimin e buxhetit vjetor dhe planit të biznesit të Shoqërisë dhe çdo ndryshim të tyre;
- g. miratimin e pasyrave financiare në mbyllje të çdo viti ushtrimor dhe raportet e ecurisë së veprimtarisë të përgatitura nga Administratori;
- h. miratimin e shpérndarjes e fitimeve vjetore;
- i. miratimin e planit vjetor të auditimit të brendshëm të Shoqërisë të hartuar nga Departamenti i Auditit në varësi të Ortakut të Vetëm;
- j. emërimin dhe shkarkimin e Administratorit dhe Drejtuesit/Menaxhët e lartë të Shoqërisë, si dhe përcaktimin e shpérblimeve përkatëse;
- k. emërimin dhe shkarkimin e ekspertëve kontabël dhe/ose likuiduesve dhe përcaktimin e shpérblimeve përkatëse;
- l. miratimin e degëve dhe zyrave të përfaqësimit të Shoqërisë brenda dhe jashtë vendimit;
- m. miratimin e themelimit të shoqërive të reja të Shoqërisë brenda dhe jashtë vendit;
- n. miratimin e krijimit të Joint Ventures dhe bashkëpunimeve të cilit do lloji qofshin që kanë të bëjnë me investim, financim, fitim të drejtrash apo pjesëmarrijesh në projekte ekzistuese apo të reja;
- o. blerjen dhe shitjen e pjesëmarjeve në shoqëri të tjera, si dhe dhënien e kontributit në kapitalin e shoqërise të tjera;
- p. miratimin e kërkesave të reja dhe vendosjen për rinovim të kërkesave ekzistuese për financim;
- q. vendosjen e barrëveve, hipotekës, pengut apo garanci të çdo lloji tjetjëri mbi pasuritë e Shoqërisë;
- r. dhënien e çdo garancie korporative ose nënshkrimin e çdo marrëveshje të tjetër për të siguruar përbushjen e detyrimeve financiare ose jo financiare ndaj të tretëve;
- s. shitjen e ndërmarrjes ose degëve të ndërmarrjes;
- t. shitjen, blerjen apo shkëmbimin e pasurive të paluajtshme dhe nënshkrimin e kontratave të sipërmarrjes në lidhje me to, duke përjashtuar këtu shitjet e njësive/objekteve të banimit dhe/ose shërbimit tek klientët e interesuar sipas një plan biznesi të miratuar përkatësisht për çdo projekt imobiliar;
- u. akordimin e huave ose paradhënieve për Administratorët ose Drejtuesit/Menaxherëve e lartë për nevoja personale;
- v. miratimi i blerjeve, shitjeve, nënshkrimi i kontratave me palë të treta për punë, shërbime apo çdo lloj marrëdhënie tjetër për një vlerë mbi 200.000 EUR (dyqind mijë Euro);
- w. shpenzimet e paparashikuara apo në devijim të buxhetit vjetor të Shoqërisë mbi një vlerë 50.000 EUR (pesëdhjetë mijë Euro);
- x. miratimin e rregullores/ve së brendshme të Shoqërisë;
- y. çështje të tjera të parashikuara nga ligji apo Statuti.

9.2 Ortaku i Vetëm mund të marrë vendime në mënyrë të vlefshme në përputhje me dispozitat e Ligjit nr. 9901, datë 14 mars 2008 “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”, i ndryshuar si dhe cdo akt ligjor/nenligjor i dal per zbatim te tij.


9.3 Në rast se Asambleja e Përgjithshme nuk mblidhet me thirjen e parë për mungesën të Ortakut të Vetëm, Asambleja e Përgjithshme do të thirret sërisht brenda 7 (shtatë) ditësh me të njëjtin rend dite.



Neni 10 – Administratori/ët

- 10.1 Shoqëria mund administrohet nga një ose më shumë Administratorë. Administratorët do të qëndrojnë në detyrë deri në shkarkim apo dorëheqje ose për një periudhë 5 (pesë) vjeçare, me mundësi rizgjedhje. Nëse Asambleja e Përgjithshme nuk merr vendim përpara mbarimit të afatit në detyrë, mandati i tyre do të rinovohet automatikisht edhe për një vit tjetër.
- 10.2 Administratori/ët përfaqëson/jnë ligjërisht Shoqërinë. Administratori ushtron të gjitha kompetencat e administrimit të zakonshëm dhe të jashtëzakonshëm të Shoqërisë, në përputhje me dispozitat e Ligjit Nr. 9901, datë 14 mars 2008 “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”, i ndryshuar, dhe vendimet e Asamblesë së Përgjithshme
- 10.3 Administratori/ët mund të emërojë/në përfaqësues me prokurë speciale (“ad negotia”) për kryerjen e një akti ose kategori aktesh në kufijtë e tagrave që u janë dhënë atyre nga ligji në fuqi ose ky Statut.
- 10.4 **Te dhenat e identifikimit te administratorit te Shoqerise dhe specimenet e nenshkrimit jane:**
- Z. LEK TUSHAJ, i identikuar nga karta e identitetit me NID H00821071F, i emeruar per një periudhe 5 vjecare me mundesi rinovimi.

Specimenet e nenshkrimit te administratorit jane:



Neni 11 – Eksperti kontabël i autorizuar

- 11.1 Nëse kërkohet nga ligji apo një vendim i tillë merret nga Asambleja e Përgjithshme, kontrolli i pasqyrave financiare dhe librave kontabël të Shoqërisë do t'i besohet një apo më shumë ekspertëve kontabël të autorizuar.
- 11.2 Eksperti kontabël i autorizuar mund të revokohet në çdo çast në bazë të kushteve të përcaktuara nga ligjet në fuqi.

KAPITULLI IV

VITI USHTRIMOR, PASQYRAT FINANCIARE VJETORE DHE SHPËRNDARJA E FITIMEVE

Neni 12– Viti finanziar dhe bilanci vjetor

- 12.1 Viti ushtrimor fillon më 1 janar dhe përfundon më 31 dhjetor.
- 12.2 Viti i parë ushtrimor fillon në datën e regjistrimit të shoqërisë në Qendrën Kombëtare të Biznesit, dhe përfundon më 31 Dhjetor, të të njëjtit vit.
- 12.3 Pasqyrat financiare dhe raporti i ecurisë i hartuar prej Administratorit dhe rapporti që, eventualisht, hartohet prej ekspertit kontabël të emëruar, miratohen prej Asamblesë së Përgjithshme (nese eshte e aplikueshme).
- 12.4 Miratimi i dokumenteve lidhur me vitin ushtrimor duhet të kryhet brenda afateve te percaktuara nga legjislacioni ne fuqi.

Neni 13 – Fitimet



13.1 Fitimet neto që rezultojnë nga pasqyrat financiare vjetore, pasi janë zbritur të gjitha shumat që Asambleja e Pergjithshme ka vendosur të destinoj per investime, i shpërndahen Ortakut të Vetëm.

13.2 Asambleja, gjithashtu, mund të vendosë të mbajë shuma të caktuara si rezerva, apo të shtyjë shpërndarjen e fitimeve – tërësisht apo pjesërisht – në vitet ushtrimore pasardhës.

KAPITULLI V SHPËRNDARJA DHE LIKUIDIMI I SHOQËRISË

Neni 14 – Shpërndarja

14.1 Shoqëria shpërndahet në përfundim të afatit të saj parashikuar në Statut apo edhe përpara këtij afati, në rastet e parashikuar nga ligji apo me vendim të Asamblesë së Përgjithshme, me shumicën e parashikuar për modifikimin e Statutit të Shoqërisë.

Neni 15 – Likuidimi

15.1 Në rast shpërndarjeje Shoqëria do të kalojë në likuidim.

15.2 Për të administruar këtë procedurë, Asambleja e Përgjithshme do të emërojë një apo më shumë likuidatorë, të cilët do të paraqesin raportin përfundimtar mbi gjendjen e pasivit dhe aktivit të Shoqërisë, mbi veprimet e likuidimit dhe kohën e nevojshme për të përfunduar likuidimin.

15.3 Pas kryerjes së pagesës së kreditorëve/ëve dhe térheqjes së kredive, likuidatori/ët do të shpërndajë të ardhurat përfundimtare të likuidimit tek ortaku/ët, proporcionalisht me kuoten që ata respektivisht kanë në kapitalin e Shoqërisë.

KAPITULLI VI DISPOZITA TË FUNDIT


Neni 16 – Zgjidhja e mosmarrëveshjeve

16.1 Të gjitha mosmarrëveshet që lindin nga ose në lidhje me interpretimin ose zbatimin e këtyre dispozitave Statutore, midis ortakëve ose midis një ose më shumë ortakëve dhe Shoqërisë, do të zgjidhen me marrëveshje midis palëve të interesuara. Në rast se nuk arrihet një zgjidhje me marrëveshje, palët do të mund t'i drejtohen Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tirana.

Neni 17 – Dispozitat ligjore në fuqi

17.1 Për gjithçka që nuk parashikohet në këtë Statut, zbatohen dispozitat ligjore në fuqi.

ORTAKU I VETEM
I SHOQERISE ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR
“SAPA CONSULTING” SHPK
LEK TUSHAJ


Lek Tushaj

Nenshkuar ne Tirane me, 15/09/2022.